



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 26 mars 2025

Njoftim për shtyp

Ndryshimet më të rëndësishme në borxhin e jashtëm, të arkëtueshmet e jashtme dhe pozitën investuese ndërkombëtare: tremujori i katërt i vitit 2024

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024, **borxhi i jashtëm bruto** është 12.320 milionë euro dhe shënoi rritje tremujore prej 449 milionë euro. **Të arkëtueshmet e jashtme bruto** u rritën për 265 milionë euro dhe arrijnë në 7.690 milionë euro. Rritja më e madhe e detyrimeve, në raport me të arkëtueshmet, solli deri në rritjen e **borxhit të jashtëm neto** për 183 milionë euro, kështu që në fund të muajit dhjetor 2024 është 4.630 milionë euro.

Borxhi i jashtëm dhe pozita investuese ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut

	31.12.2023		30.09.2024		31.12.2024		Ndryshimet tremujore			ndryshimet në krahasim me fundin e vitit të kaluar		
	mill. EUR	% GDP	mill. EUR	% GDP	mill. EUR	% GDP	mill. EUR	%	p.p.	mill. EUR	%	p.p.
Borxhi i jashtëm bruto	11,356.1	77.9	11,871.6	77.0	12,320.2	79.9	448.7	3.8	2.9	964.2	8.5	2.0
Borxhi i jashtëm bruto – Pa përfshirë borxhin e Bankës Qendrore nga marrëveshjet repo	10,990.4	75.4	11,479.7	74.4	12,111.9	78.5	632.2	5.5	4.1	1,121.4	10.2	3.2
Borxh afatgjatë	8,498.4	58.3	8,695.6	56.4	9,279.6	60.2	583.9	6.7	3.8	781.2	9.2	1.9
Borxh afatshkurtër	2,857.6	19.6	3,175.9	20.6	3,040.6	19.7	-135.3	-4.3	-0.9	183.0	6.4	0.1
Borxh afatshkurtër pa repo	2,492.0	17.1	2,784.0	18.1	2,832.3	18.4	48.3	1.7	0.3	340.3	13.7	1.3
Borxhi publik pa repo	5,577.9	38.2	5,521.6	35.8	5,869.8	38.1	348.1	6.3	2.3	291.8	5.2	-0.2
Borxhi publik pa repo	5,212.3	35.7	5,129.7	33.3	5,661.4	36.7	531.7	10.4	3.4	449.1	8.6	1.0
Borxhi privat	5,778.1	39.6	6,349.9	41.2	6,450.5	41.8	100.5	1.6	0.7	672.3	11.6	2.2
Kërkesat e jashtme bruto	6,989.5	47.9	7,424.7	48.1	7,690.1	49.9	265.4	3.6	1.7	700.6	10.0	1.9
Kërkesat e Bankës Qendrore nga marrëveshjet e anasjellta repo	6,989.3	47.9	7,236.4	46.9	7,603.0	49.3	366.6	5.1	2.4	613.7	8.8	1.4
Borxhi i Jashtëm Neto	4,366.6	29.9	4,446.9	28.8	4,630.1	30.0	183.3	4.1	1.2	263.6	6.0	0.1
Borxhi i Jashtëm Neto pa repo	4,001.1	27.4	4,243.2	27.5	4,508.9	29.2	265.7	6.3	1.7	507.8	12.7	1.8
PIN, neto	-8,311.3	-57.0	-8,574.0	-55.6	-8,766.7	-56.8	-192.7	2.2	-1.2	-455.3	5.5	0.1

*/Të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për vitin 2023 është vlerësim paraprak, ndërsa për vitin 2024 është e dhënë e vlerësuar (burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, njoftimi "Prodhimi i brendshëm bruto, tremujori i katërt i vitit 2024" nga 4.3.2025).

Burimi: BPRMV, EShS.

Pozita **negative e investimeve ndërkombëtare neto**¹, në fund të muajit dhjetor 2024, është 8.767 milionë euro, ose 56,8% e PBB-së² për vitin 2024. Nga kjo shumë, pjesa më e madhe, ose 94%, janë detyrimet neto të bazuara në investime direkte, nga të cilat 67% janë në bazë të kapitalit vetanak.

¹ Pozita investuese ndërkombëtare (PIN) paraqet raport statistikor që tregon gjendjen e mjeteve dhe detyrimeve financiare të jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në një datë të caktuar, d.m.th. të arkëtueshmet dhe detyrimet ndaj jorezidentëve bazuar në instrumente financiare. Për më tepër, pozita negative e investimeve ndërkombëtare neto do të thotë se detyrimet financiare tejkalojnë kërkesat financiare nga jorezidentët.



² E dhëna për PBB-në për vitin 2024 është e dhënë e vlerësuar (burimi: Enti Shtetëror për Statistikë, njoftimi "Prodhimi i brendshëm bruto, tremujori i katërt i vitit 2024" nga 4.3.2025).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Borxhi i jashtëm bruto

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2024, borxhi i jashtëm bruto është 12.320 milionë euro (ose 79,9% e PBB-së) dhe shënon rritje tremujore prej 449 milionë euro (ose për 3,8%). Nëse nga borxhi përjashtohet ndikimi i aktiviteteve specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore³, borxhi bruto shënoi rritje tremujore prej 632 milionë euro. Ky ndryshim tremujor është rezultat i rritjes së borxhit publik (për 532 milionë euro) dhe borxhit privat (për 101 milionë euro). Rritja tremujore e borxhit publik të jashtëm prej 532 milionë euro është rezultat i rritjes së borxhit të sektorit "shtetëror" (për 465 milionë euro⁴), në bankat publike dhe ndërmarrjeve publike (për 61 milionë euro) dhe në bankën qendrore (për 6 milionë euro). Rritja tremujore e borxhit privat është rezultat i rritjes së borxhit të bankave private (për 99 milionë euro) dhe sektorit privat jobankar (për 45 milionë euro), gjatë rënies së borxhit të subjekteve të lidhura me kapitalin (për 43 milionë euro).



Burimi: BPRMV, EShS.

Krahasuar me fundin e vitit 2023, borxhi i jashtëm bruto është më i lartë për 964 milionë euro, ose për 8,5%. Ndërkaq, borxhi me efekt të përjashtuar nga aktivitetet specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore është rritur për 1.121 milionë euro. Rritja e arritur është rezultat i rritjes së borxhit të jashtëm privat (për 672 milionë euro) dhe borxhit publik (për 449 milionë euro). Në borxhin privat, rritje është vërejtur te subjektet e lidhura me kapitalin (për 508 milionë euro) dhe sektori privat jobankar (për 227 milionë euro), ndërsa borxhi i bankave private shënoi ulje (për 63 milionë euro). Në lidhje me borxhin publik, rritja është rezultat i rritjes së detyrimeve në sektorin "shtetëror" (për 409 milionë euro), i bankave publike dhe ndërmarrjeve publike (për 34 milionë euro) dhe rritja e detyrimeve në bankat qendrore (për 6 milionë euro).

³ Aktivitetet specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore i referohen marrëveshjeve repo dhe operacioneve të tjera që lidhen me menaxhimin e rezervave valutore. Me rastin e përfundimit të këtyre transaksioneve krijohen detyrime (të klasifikuara në kategorinë "kredi") që kontribuojnë në rritjen e nivelit të borxhit bruto. Në të njëjtën kohë, gjatë përfundimit të këtyre transaksioneve në drejtim të kundërt, të arkëtueshmet e krijuara kontribuojnë në rritjen e të arkëtueshmeve bruto. Të marra në tërësi, këto transaksione kanë një efekt neutral në bazën neto nëse ato kryhen njëkohësisht në të njëjtën shumë. Nëse transaksionet e kryera nuk janë me shumë identike në të dy drejtimet, ato kanë ndikim në borxhin e jashtëm bruto dhe neto dhe në të arkëtueshmet bruto.

⁴ Kryesisht si rezultat i huamarrjes së shtetit nga kreditor bilateral në vlerën 500 milionë euro.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Të arkëtueshmet e jashtme bruto

Të arkëtueshmet e jashtme bruto, në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024, arrijnë 7.690 milionë euro (ose 49,9% e PBB-së) dhe vërejtën rritje tremujore prej 265 milionë euro (ose për 3,6%). Nëse përjashtohet ndikimi i aktiviteteve specifike të bankës qendrore lidhur me menaxhimin e rezervave valutore, të arkëtueshmete jashtme bruto janë rritur për 367 milionë euro dhe janë 7.603 milionë euro. Ky ndryshim tremujor është rezultat i rritjes së të arkëtueshmeve publike për 594 milionë euro, me ulje të të arkëtueshmeve private për 227 milionë euro. Rritja tremujore e të arkëtueshmeve publike vjen si pasojë e rritjes së të arkëtueshmeve të bankës qendrore. Ulja e të arkëtueshmeve të jashtme në sektorin privat është rezultat i uljes së të arkëtueshmeve të subjekteve të lidhura me kapitalin (për 351 milionë euro), në kushte të rritjes së depozitave të institucioneve (për 79 milionë euro) dhe sektorëve të tjerë (për 44 milionë euro).

Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, të arkëtueshmet e jashtme bruto janë më të larta për 701 milionë euro. Pa efektin e aktiviteteve specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore, të arkëtueshmet e jashtme bruto u rritën për 614 milionë euro, dhe atë si rezultat i rritjes së të arkëtueshmeve publike dhe private (për 349, respektivisht 264 milionë euro). Rritja vjetore e të arkëtueshmeve publike vjen si pasojë e rritjes së të arkëtueshmeve të bankës qendrore. Rritja e të arkëtueshmeve private vjen nga rritja e të arkëtueshmeve të sektorëve të tjerë (për 220 milionë euro) dhe institucioneve depozituese (për 65 milionë euro), me ulje të të arkëtueshmeve të subjekteve të lidhura me kapitalin (për 20 milionë euro).



Burimi: BPRMV, EShS.



Borxhi i jashtëm neto

Më 31.12.2024, borxhi i jashtëm neto është 4.630 milionë euro (ose 30% nga PBB-ja). Borxhi i jashtëm neto i vendit, në tremujorin e katërt të vitit 2024 është rritur për 183 milionë euro, ose për 4,1%. Nga aspekti strukturor, borxhi privat neto vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të madhe në totalin e borxhit neto me 71,7%.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Në lidhje me fundin e vitit 2023, borxhi i jashtëm neto është rritur për 264 milionë euro (ose 6%), në kushtet e rritjes së borxhit publik neto (për 408 milionë euro) dhe ulje të borxhit privat neto (për 144 milionë euro).



Burimi: BPRMV, ESHS.

Pozita investuese ndërkombëtare, neto

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, pozicioni negativ i investimeve ndërkombëtare neto (PIN) është rritur për 193 milionë euro dhe është 8.767 milionë euro, që paraqet 56,8% nga PBB-ja e vitit 2024.

Rritja tremujore e PIN-it negativ, neto, rezulton nga rritja më e madhe e detyrimeve (për 543 milionë euro), në raport të rritjes së mjeteve (për 350 milionë euro). Parë nga instrumentet, detyrimet neto të bazuara në instrumentet e borxhit janë rritur për 183 milionë euro, ndërsa detyrimet neto të bazuara në instrumente vetanake shënuan rritje për 9 milionë euro.

Në krahasim me fundin e vitit 2023, PIN-i negativ, neto, është rritur për 455 milionë euro, si rezultat i rritjes së detyrimeve neto bazuar në instrumentet e borxhit dhe vetanake (për 264, respektivisht 192 milionë euro).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Pozita investuese ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut


(në milionë euro)

PIN, sipas instrumenteve	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	T1 2023	T2 2023	T3 2023	T4 2023	T1 2024	T2 2024	T3 2024	T4 2024
Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare neto	-5,082.7	-5,576.0	-5,822.5	-6,039.5	-6,458.4	-6,900.6	-7,244.9	-8,129.2	-8,016.0	-8,195.7	-8,083.1	-8,311.3	-8,468.5	-8,667.1	-8,574.0	-8,766.7
Mjetet	4,571.9	5,171.3	5,157.3	5,913.6	6,163.8	6,172.5	7,041.4	7,666.7	8,123.5	8,355.6	8,234.8	8,375.8	8,927.4	8,947.0	9,073.9	9,424.0
Investimet direkte	655.0	811.9	967.6	896.2	936.8	784.3	915.5	1,014.8	1,215.3	1,323.5	1,476.5	1,042.0	1,381.9	1,371.6	1,395.7	1,059.7
Investimet e portofolit	212.6	255.2	300.2	321.2	406.1	470.9	650.0	695.3	736.3	778.8	810.7	917.0	947.2	980.5	1,033.7	1,146.1
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opsionet e aksioneve të punonjësve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitalet tjera	1.0	1.2	2.8	2.9	4.4	4.5	6.0	6.0	5.9	5.9	5.8	5.8	6.0	5.7	5.7	4.9
Valuta dhe depozitat	615.4	627.3	635.5	694.0	580.0	562.9	657.6	653.5	561.9	604.7	676.5	650.9	611.7	613.3	644.6	661.4
Kreditë	67.1	52.1	56.1	74.5	79.1	87.3	125.9	221.6	154.6	158.5	187.9	74.7	433.7	331.4	278.3	180.7
Sigurimet, pensionet dhe skemat e standardizuara garancie	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanset	757.4	809.6	858.8	1,057.2	894.4	902.3	1,042.3	1,212.4	1,290.0	1,294.0	1,175.2	1,146.5	1,259.5	1,306.1	1,308.5	1,340.8
Logarit tjera të arkëtueshme/pagueshme	1.7	0.5	0.1	0.5	0.3	0.4	0.9	0.3	0.2	0.4	0.5	0.6	0.3	0.9	0.9	1.4
Aktive reserve	2,261.8	2,613.4	2,336.3	2,867.1	3,262.6	3,359.9	3,643.3	3,862.9	4,159.2	4,189.7	3,901.7	4,538.4	4,287.1	4,337.5	4,406.6	5,029.0
Detyrimet	9,654.6	10,747.3	10,979.8	11,953.0	12,622.2	13,073.1	14,286.3	15,795.9	16,139.5	16,551.2	16,317.9	16,687.2	17,395.9	17,614.1	17,647.8	18,190.7
Investimet direkte	4,951.3	5,392.2	5,598.1	6,141.3	6,580.0	6,537.1	7,089.2	7,853.6	8,112.9	8,298.8	8,440.1	8,281.5	8,770.5	9,002.8	9,280.7	9,330.8
Investimet e portofolit	848.8	1,362.2	1,476.3	1,813.2	1,730.7	2,103.8	2,159.2	2,106.7	2,564.5	2,592.2	2,227.4	2,323.0	2,210.0	2,184.3	2,148.4	2,146.5
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opsionet e aksioneve të punonjësve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitalet tjera	4.3	6.0	2.3	4.2	4.0	5.0	2.7	3.3	5.5	7.7	9.9	12.1	13.6	14.1	17.4	18.6
Valuta dhe depozitat	148.5	174.2	195.2	206.2	254.2	253.3	297.3	471.0	363.4	398.9	300.1	462.0	335.4	349.5	316.7	428.9
Kreditë	2,961.7	3,014.7	2,872.0	2,883.4	3,100.9	3,267.2	3,580.3	4,043.3	3,790.7	3,944.0	4,005.8	4,257.3	4,629.9	4,577.9	4,428.3	4,775.1
Sigurimet, pensionet dhe skemat e standardizuara garancie	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanset	656.7	714.6	757.7	824.8	871.1	827.8	910.3	1,062.6	1,054.0	1,064.7	1,085.4	1,107.1	1,189.3	1,237.8	1,211.6	1,240.3
Logarit tjera të arkëtueshme/pagueshme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.4	0.0	5.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të drejta të veganta të arkëtimit (india e detyrimeve neto)	83.2	83.2	78.2	79.8	81.3	77.4	247.3	250.5	248.5	244.8	249.2	244.2	247.2	247.8	244.8	250.5

Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV, EShS.



Rishikimet e të dhënave

Të dhënat mbi borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat në këtë njoftim përmbajnë rishikime të rregullta të të dhënave për periudhën janar - shtator 2024. Ndryshimet në borxhin e jashtëm bruto dhe të kërkesat rezultojnë nga mbulimi më i mirë i të dhënave për huamarrjet dhe kreditë tregtare dhe paradhëniet. Nga këndvështrimi i kahut të ndryshimeve, rishikimi i të dhënave çoi në rritje të borxhit të jashtëm bruto në tremujorin e parë të vitit 2024 për 8 milionë euro, në tremujorin e dytë për 17,4 milionë euro dhe në tremujorin e tretë për 14,8 milionë euro, ndërkohë që kërkesat e jashtme bruto janë ulur në dy tremujorët e parë të vitit 2024 (për 8,9, respektivisht 3,6 milionë euro), ndërsa në tremujorin e tretë kërkesat e jashtme bruto janë pothuajse të pandryshueshme. Kështu, këto ndryshime janë reflektuar si rritje e borxhit të jashtëm neto në tremujorin e parë për 16,9 milionë euro, në tremujorin e dytë për 21,1 milionë euro dhe në tremujorin e tretë për 14,9 milionë euro.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Rishikimi i të dhënave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare, neto, çoi në rritje të PIN-it negativ për 21,6 milionë euro në tremujorin e parë, për 30,8 milionë euro në të dytin dhe për 29,5 milionë euro në të tretin. Përveç ndryshimeve në instrumentet e borxhit, revizioni mbulon edhe ndryshimet në instrumentet vetanake, të cilat janë pothuajse tërësisht rezultat i të dhënave të reja të marra nga raportet tremujore për rezultatet financiare të arritura dhe të planifikuara të shoqërive me investime direkte nga jashtë.

Informacione mbështetëse

Të dhënat të serive kohore - të dhëna vjetore dhe tremujore për borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat e jashtme bruto:

https://www.nbrm.mk/nadvoresen_dolg-al.nspix

Të dhënat të serive kohore - të dhëna vjetore dhe tremujore për pozitën e investimeve ndërkombëtare:

https://www.nbrm.mk/megunarodna_investiciska_pozicija-al.nspix

Shpjegime metodologjike mbi borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat:

http://nbrm.mk/content/statistika/ND/metodologija/Metodologija_nadvoresen_dolg_5_2_2018.pdf

Shpjegime metodologjike për pozitën e investimit ndërkombëtar:

http://nbrm.mk/content/statistika/mip/metodologija/Metodologija_MIP_BPM6_9_10_2018.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave:

https://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci-al.nspix

Borxhi i jashtëm bruto tremujor, kërkesat e jashtme bruto dhe pozita e investimeve ndërkombëtare: 24 qershor 2025 (seksioni i referencës përmbyllur me marsin e vitit 2025).

Për pyetje nga mediat, ju lutemi kontaktoni personat përgjegjës nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informata më të detajuara lidhur me të dhënat statistikore të publikuara, mund të na kontaktoni në contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin telefonik 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).